

# KRIJIMI I IDENTITETIT [BRENDIMIT] PËR **INDUSTRINË TIK** NË KOSOVË DHE ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRUAR TË MARKETINGUT (05/STIKK/2019)

## 1. Hyrje

Si një katalizator në industrinë dinamike të teknologjisë, STIKK përshpejton rritjen dhe progresin në ekonomi. STIKK ofron një platformë që bashkon liderët e teknologjisë për t'u lidhur dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe mbështet me entuziazëm anëtarët që shtyjnë përpara kufijtë e teknologjisë.

Që nga themelimi në 2008, STIKK arriti suksese të shumta dhe u bë një nga shtytësit kryesorë të industrisë së TIK-ut dhe komunitetit të TIK-ut në Kosovë. Gjatë përpjekjeve drejt zhvillimit të vazhdueshëm të industrisë së TIK, STIKK ka realizuar projekte të shumta që kanë për qëllim promovimin e sektorit të TIK të Kosovës, përmirësimin e kornizës ligjore, implementimin e hulumtimeve dhe analizave specifike të industrisë si dhe të ndihmojë në zhvillimin e profesional të aktorëve të sektorit.

Është fakt se industria e TIK-ut në Kosovë është njëra nga industritë të cilat gëzojnë përqindjen më të madhe dhe pozitive të eksportit të shërbimeve/produkteve të ofruara, kjo industri është edhe njëri nga ambasadorët më të mirë dhe frytdhënës në promovimin e aftësive, dijes, eksperiencës, kreativitetit dhe inovacionit të cilin e posedojnë kompanitë e këtij sektori në Kosovë tek partnerët, klientët dhe audienca jasht vendit tonë. Që nga themelimi, STIKK ka qenë ura kryesore e ndërlidhjes në mes të kompanive lokale dhe partnerëve/klientëve të huaj përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në takimit të shumta B2B, konferencave botërore me tema të ndryshme rreth TIK-ut dhe panaireve ku janë prezantuar projektet e ndryshme të kompanive vendore në nivel ndërkombëtarë.

## 2. Qëllimet dhe rezultatet e pritura

*Qëllimi i krijimit të identitetit për industrinë e TIK-ut në Kosovë:*

1. Të krijohet një identitet i përgjithshëm i industrisë së TIK-ut, i cili do të përdoret për t'a promovuar sektorin e TIK-ut në nivel ndërkombëtar;
2. Të krijohet një dokument gjithpërfshirës (whitepaper) me statistikat dhe informatat e rëndësishme të sektorit të zberthyer në format të qartë që do të përdoret si pasqyrë e gjendjes së sektorit;
3. Të paraqes një pasqyrë profesionale dhe të organizuar të sektorit të TIK;
4. Të krijohet një gjuhë gjithpërfshirëse për komunikimin e të dhënave rreth sektorit të TIK;
5. Të krijohet një "Brand Book" për përdorimin e duhur të identitetit të ri i cili do të shfrytëzohet si udhërrëfyes për komunikim dhe promovim të sektorit nga palët e ndryshme;
6. Të definohen kanalet e duhura të komunikimit për promovimin e sektorit të TIK-ut në mënyrë sa më të denjë dhe të kuptueshme për audiencën ndërkombëtare;
7. Të zhvillohet një plan i integruar i Marketingut për komunikimin dhe promovimin e identitetit të ri;
8. Të unifikohen të dhënat të cilat komunikohen rreth sektorit në mënyrë që të paraqitet një pasqyrë e sakt e sektorit nga të gjitha palët e interesit (STIKK; kompanitë e TIK-ut; Institucionet Qeveritare; Partnerët; etj.).

### 3. Dokumentet e nëvojshme

Të gjitha shprehjet e interesit duhet të përmbajnë:

#### A. PROFIL DHE PORTFOLIO TË KOMPANISË

*Ju lutem ofroni një përshkrim të shkurtër të kompanisë / institucionit tuaj.*

#### B. PËRVOJA/KUALIFIKIMI

*Shprehja e interesit duhet të përfshijë një histori të shkurtër të kompanisë, madhësinë e saj, përvojën dhe kualifikimet e saj me ofrimin e shërbimeve të ngjashme me ato të cekura në qëllime dhe rezultate.*

#### C. REFERENCA PËR PUNË PARAPRAKE

*Ju lutemi bashkangjitni referencat për punë paraprake të kompanisë, duke përfshirë emrat, kompaninë/organizatën, si dhe informacionin e kontaktit për tre (ose më shumë) klientë të cilët mund të ofrojnë njohuri në lidhje me kualifikimin dhe ofrimin e shërbimeve.*

### 4. Udhëzime për dorëzim të shprehjeve të interesit

Kompanitë duhet të dërgojnë shprehjen e tyre të interesit deri më **19 prill 2019** në orën **12:00** në [info@stikk.org](mailto:info@stikk.org).

Kohëzgjatja për realizimin e projektit dhe dorëzimin e materialeve të lartpërmendura është **10 maj** deri më **09 Gusht 2019**.